

Migrimi i kosovarëve në Gjermani

ANALIZË STATISTIKORE



Migrimi i kosovarëve në
Gjermani: Analizë statistikore

—
Shtator 2023

— **Përmbajtja**

| | |
|-----------------------------------|----|
| Përmbledhje ekzekutive | 3 |
| Hyrje | 4 |
| Emigrimi i kosovarëve në Gjermani | 5 |
| Përfundim | 16 |
| Aneks | 17 |

Përmbledhje ekzekutive

Shtetet e Ballkanit Perëndimor historikisht janë karakterizuar me shkallë të lartë të emigrimit (largimit nga shteti i origjinës). Edhe në vitet e fundit, kryesisht për shkak të zhvillimit ekonomik më të ngadalshëm të tyre dhe pamundësisë për t'u përafuar me standardet e shteteve të zhvilluara, qytetarët e këtyre vendeve po kërkojnë mundësi dhe kushte më të mira jashtë rajonit. Në dekadën e fundit, shkalla e emigrimit nga Ballkani Perëndimor u rrit me 10%, ndërsa sot, rreth 20% e popullsisë së këtij rajoni jeton jashtë shteteve të origjinës.

Emigrimi është faktor mjaft kompleks dhe sfidues edhe për Kosovën, trendet e të cilit vazhdojnë të luajnë rol të jashtëzakonshëm në zhvillimet ekonomike dhe politike në vend. Historikisht, Kosova është përballur me largimin e qytetarëve drejt vendeve të zhvilluara perëndimore, destinacionet kryesore të të cilëve kanë qenë Gjermania, Zvicra dhe Austria. Përkundër faktit që pjesa më e madhe e diasporës kosovare jeton në Gjermani, reformat e migrimit të nxitura kryesisht si pasojë e mungesës së fuqisë punëtore në Gjermani, vazhdojnë të tërheqin kosovarët, duke ndikuar që trendi i emigrimit ende të vazhdojë në masë të madhe. Për të vlerësuar ndikimin ekonomik, politik dhe social të emigrantëve nga Kosova në vende si Gjermania, është e rëndësishme të kemi të dhëna të sakta mbi demografinë e tyre. Si rrjedhojë, njohuritë e detajuara rreth karakteristikave të emigrantëve mundësojnë formulimin e politikave të duhura të cilat adresojnë mundësitë dhe sfidat që lidhen me migrimin.

Përmes këtij raporti, Instituti GAP ka analizuar të dhënat e emigrimit të kosovarëve në Gjermani, duke përdorur rezultatet e regjistrimeve/mikrocensuseve nga Zyra Federale e Statistikave Gjermane për vitet 2010 – 2022. Disa nga gjetjet kryesore të hulumtimit janë:

- Sipas matjeve të vitit 2022, në Gjermani jetojnë 542 mijë persona me sfond migrimi nga Kosova, nga të cilët 330 mijë kanë lindur në Kosovë.
- Në periudhën 12 vjeçare, 2010–2022, vërehet rritje prej 251 mijë apo 86% më shumë persona me sfond migrimi nga Kosova në Gjermani.
- Të dhënat e tregut të punës në Gjermani tregojnë se, nga 264 mijë persona aktivë me sfond migrimi nga Kosova, 251 mijë janë të punësuar (160 mijë burra dhe 91 mijë gra), ndërsa 13 mijë janë të papunë (tetë mijë burra dhe pesë mijë gra).
- Të dhënat nga edukimi i përgjithshëm tregojnë se numri i personave të cilët posedojnë diplomë të shkollës së mesme është më i madh se ata të cilët nuk kanë diplomë të tillë. E njëjta nuk vlen për kualifikime profesionale, ku numri i personave të cilët nuk kanë kualifikime profesionale është konsiderueshëm më i madh se ata që kanë kualifikime të tilla.
- Te dhënat nga viti 2017 deri në 2022 tregojnë se arsyet kryesore të emigrimit në Gjermani për të gjithë personat e lindur në Kosovë janë kryesisht bashkimi familjar dhe azil-kërkimi. Në vitin 2022, 110 mijë persona deklaruan se bashkimi familjar është arsyeja kryesore e emigrimit të tyre; 85 mijë persona deklaruan se arsyeja kryesore është arratisja, azil-kërkimi dhe mbrojtja ndërkombëtare; 64 mijë persona deklaruan si arsye punësimin, ndërkaq 41 mijë të tjerë emigruan për të krijuar familje.
- Vetëm në vitin 2021, 21,487 persona kanë hyrë nga Kosova në Gjermani, dhe 4,323 persona me origjinë nga Kosova janë larguar nga Gjermania, ku migrimi neto në këtë vit ishte 17,164 persona.

Hyrje

Arsyet pse njerëzit migrojnë ndryshojnë vazhdimisht, por ndikimi ekonomik, politik dhe social i lëvizjes së popullsisë kryesisht nga vendet më pak të zhvilluara në ato më të zhvilluara, po bëhet gjithmonë e më i rëndësishëm.¹ Shtetet e Ballkanit Perëndimor karakterizohen me shkallë të lartë të emigrimit, ndër të cilat, Kosova renditet e treta me rreth një të tretën e popullsisë që jeton jashtë vendit.²

Kosova ka një histori të gjatë të largimit të qytetarëve të saj; histori e cila ka kaluar në faza të ndryshme.³

Faza e parë e emigrimit filloi në vitet e 1960-ta, kur Kosova ishte pjesë e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ). Reformat ekonomike liberale të vitit 1965, rezultuan në hapje të kufinjëve të RSFJ-së, ku si pasojë, qytetarët emigruan kryesisht në vendet perëndimore evropiane (Gjermani Perëndimor, Zvicër dhe Austri) të cilat ishin të hapura për rekrutimin e përkohshëm të fuqisë punëtore.⁴ Këta emigrantë, të ashtuquajtur 'Gastarbeiter' që nënkupton 'punëtorë mysafirë',⁵ ishin kryesisht burra të pakualifikuar nga zonat rurale të Kosovës dhe si të tillë, pa synime për tu integruar në shtetet ku ata emigruan.⁶ Faktorët ekonomikë si papunësia e lartë dhe zhvillimi i ulët industrial, e karakterizuan fazën e parë të emigrimit nga Kosova në Gjermani.⁷

Faza e dytë e emigrimit përmbante më shumë gjurmë politike, ndonëse kushtet e rënda ekonomike vazhdonin të luanin rol të rëndësishëm në emigrimin nga Kosova.⁸ Në vitet 1981–89, zhvillimet politike në RSFJ, të cilat rezultuan në tërheqjen e autonomisë së Kosovës, e ndryshuan dramatikisht klimën politike në vend. Nxitur nga humbja e vendeve të punës dhe shmangia e shërbimit të obliguar ushtarak, qytetarët nga Kosova filluan të largohen në masë të madhe. Për dallim nga faza e parë, këtu u përfshinë edhe individët e kualifikuar nga të gjitha zonat e Kosovës.⁹

Faza e tretë e emigrimit, njëkohësisht, faza më dramatike e zhvendosjes masive të popullsisë, ndodhi në vitet 1998–99, gjatë luftës në Kosovë. Megjithëse shumica e të zhvendosurve u rikthyen në Kosovë – rreth 600 mijë persona, nga gjithsej 850 mijë të zhvendosur – një numër i konsiderueshëm vazhduan qëndrimin në shtetet ku ata strehoheshin.¹⁰ Ndonëse ishin faktorët politikë të cilët shkaktuan eksodin më të madh ndonjëherë në Kosovë, qëndrueshmëria ekonomike e emigrantëve në shtetet strehuese, e dekurajoi rikthimin dhe përbaljen e tyre me procesin e rindërtimit të shtetit të Kosovës.¹¹

1 Ratha, Dilip, et al., [Ndikimi i migrimit në zhvillimin ekonomik dhe social: Një rishikim i provave dhe çështjeve në zhvillim](#), p.3, 2011.

2 OECD, [Migrimi i fuqisë punëtore në Ballkanin Perëndimor: Hartimi i modeleve, adresimi i sfidave dhe mbledhja e përfitimeve](#), p.16, 2022.

3 Kotorri, Mrika. "[Një hetim mbi migracionin ekonomik me referencë të veçantë për Kosovën](#)", p.3, 2011.

4 OECD, [Migrimi i fuqisë punëtore në Ballkanin Perëndimor: Hartimi i modeleve, adresimi i sfidave dhe mbledhja e përfitimeve](#), p.19, 2022.

5 Punëtorët e përkohshëm në Gjermani punonin kryesisht në industrinë e prodhimit dhe ndërtimit, ku mungesa e fuqisë punëtore ishte më e dukshme. Martin, Philip L., "[Punëtorët mysafirë të Gjermanisë](#)", JSTOR, 1981.

6 Në vitet 1960–70, ishin kryesisht banorët e zonave rurale të cilët nuk mund të prodhonin mjaftueshëm ushqim për familjet tradicionale të tyre, gjë që i shtyu ata të kërkonin mundësi punësimi të përkohshëm në Gjermani. Möllers, Judith, et.al. "[Studim mbi migrimin rural dhe migrimin e kthimit në Kosovë](#)", p.13, 2017.

7 Jusufi, Gëzim. et al., "[Migrimi dhe zhvillimi ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor: Dëshmi nga Kosova](#)", pp.147-148, 2020.

8 Jusufi, Gëzim. et al., "[Migrimi dhe zhvillimi ekonomik në vendet e ballkanit perëndimor: Dëshmi nga Kosova](#)", p.148, 2020

9 Sipas Human Rights Watch, 350 mijë kosovarë-shqiptarë, kryesisht të rinj, emigruan gjatë fillimit dhe mesit të viteve 1990 si rezultat i marginalizimit të tyre nga regjimi i dominuar serb. King, Russell, et al. "[Migrimi dhe zhvillimi në ekonomitë në tranzicion të Evropës juglindore: Shqipëria dhe Kosova](#)." Eastern European Economics, JSTOR, 2010.

10 OECD, [Migrimi i fuqisë punëtore në Ballkanin Perëndimor: Hartimi i modeleve, adresimi i sfidave dhe mbledhja e përfitimeve](#), p.22, 2022.

11 Kotorri, Mrika. "[Një hetim mbi migracionin ekonomik me referencë të veçantë për Kosovën](#)",p.3, 2011.

Faza e katërt e emigrimit përfshin vitet e pasluftës deri në vitin 2015, ku qytetarët e Kosovës emigruan drejt vendeve perëndimore për arsye ekonomike dhe sociale.

Të gjitha këto faza të emigrimit u movituan nga arsye kryesisht politike, por që më vonë, rrethanat e qëndrueshme ekonomike e dekurajuan rikthimin e këtyre emigrantëve në Kosovë, duke ndikuar që sot, diaspora e Kosovës të jetë e madhe në numër.

Gjermania historikisht ka qenë destinacioni kryesor i emigrantëve nga Kosova, duke rezultuar në shtetin me numrin më të madh të diasporës së Kosovës. Mungesa e fuqisë punëtore në Gjermani dhe hapja e tregut të punës për gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor ndikuan që në vitet e fundit, emigrimi drejt Gjermanisë të rritet akoma më shumë. Në vitin 2022, shteti gjerman u përball me mungesën më të madhe të fuqisë punëtore të shënuar ndonjëherë, me 1.74 milion pozita të lira të vendeve të punës.¹² Si rrjedhojë, Gjermania është vazhdimisht duke miratuar politika të cilat e lehtësojnë migrimin drejt saj. Por, sa persona me sfond migrimi nga Kosova aktualisht jetojnë në Gjermani?

Në këtë raport, Instituti GAP synon të paraqes të dhëna të detajuara të numrit të kosovarëve të cilët jetojnë në Gjermani, duke u bazuar në rezultatet e regjistrimeve/mikrocensuseve nga Zyra Federale e Statistikave të Gjermanisë. Këto të dhëna përfshijnë vitet 2010 – 2022. Përveç numrit total sipas sfondit të migrimit, në mënyrë specifike, në këtë raport paraqiten të dhënat e ndara sipas gjinisë, grup-moshave, vendbanimeve, edukimit të përgjithshëm, kualifikimeve profesionale, strukturës familjare, fuqisë punëtore, të hyrave mujore neto të personave të punësuar, punësimit sipas sektorëve ekonomikë, arsyet e migrimit, gjuhët e folura, si dhe lëvizjet e popullsisë.

Emigrimi i kosovarëve në Gjermani

Sipas statistikave më të fundit të vitit 2022, në Gjermani jetojnë 542 mijë persona me sfond migrimi nga Kosova. Raporti i mikrocensusit në kategorinë 'sfond migrimi' përfshin të gjithë personat "të cilët... ose nëse të paktën njëri nga prindërit e tyre, nuk ka lindur me shtetësi gjermane".¹³ Në këtë kategori përfshihen: 1) imigrantë dhe jo-imigrantë të huaj; 2) imigrantë dhe jo-imigrantë të natyralizuar; 3) të rizhvendosurit; 4) personat që marrin nënshtetësinë gjermane ndërmjet adoptimit nga një prind gjerman; si dhe, 5) fëmijët e lindur me shtetësi gjermane në katër grupet e lartpërmendura.¹⁴


Nga krahasimi i të dhënave të vitit 2022 me ato të vitit 2010, konstatohet se numri i qytetarëve me origjinë nga Kosova që jetojnë në Gjermani pothuajse është dyfishuar. Rrjedhimisht, në një periudhë kohore 12 vjeçare shënohet rritje nga 291 mijë në 542 mijë, që rezulton në 251 mijë apo 86% më shumë persona me sfond migrimi nga Kosova.

Sipas ndarjes gjinore, të dhënat tregojnë se nga 542 mijë persona, 289 mijë (53%) janë burra ndërsa 254 mijë (47%) janë gra. Në çdo vit nga 2010 deri në 2022, burrat dominojnë me pjesëmarrje më të lartë në popullsi krahasuar me gratë.

¹² Euronews, "Gjermania do të miratojë ligjin për reformën e imigracionit duke e bërë më të lehtë për punëtorët e huaj", 2023.


¹³ Zyra Federale e Statistikave të Gjermanisë (Destatis), [Informacion rreth statistikave; Mikrocensusi – popullsia sipas sfondit të Migrimit](#), 2020-2022.

¹⁴ Po aty.

Figura 1. Popullsia me origjinë nga Kosova në Gjermani, 2010 – 2022


Burimi: Zyra Federale e Statistikave të Gjermanisë (Destatis) 2010 – 2022

Nga 542 mijë persona me sfond migrimi nga Kosova, 330 mijë prej tyre kanë lindur në Kosovë. Që nga viti 2010, ky numër është rritur nga 189 mijë në 330 mijë. Rritja më e lartë vërehet nga viti 2021 deri në vitin 2022, me 44 mijë (15%) mijë persona më shumë. Sipas ndarjes gjinore, të dhënat tregojnë se nga 330 mijë persona, 177 mijë (54%) janë burra, ndërsa 153 mijë (46%) janë gra.

Figura 2. Popullsia e lindur në Kosovë me migrim në Gjermani, 2010 – 2022


Burimi: Zyra Federale e Statistikave të Gjermanisë (Destatis) 2010 – 2022

Sipas të dhënave të vitit 2022, 176 mijë persona (32.5%) me origjinë nga Kosova i takojnë grup-moshës 25 deri në 45 vjeç, duke pasuar nga 147 mijë nën 15 vjeç (27.1%); 106 mijë nga mosha 45 deri në 65 vjeç (19.5%); 95 mijë nga mosha 15 deri në 25 vjeç (17.5%); dhe 18 mijë mbi moshën 65 vjeç (Tabela 1 në aneks).

Figura 3. Diaspora kosovare në Gjermani sipas grup-moshave, 2010 – 2022

Burimi: Zyra Federale e Statistikave të Gjermanisë (Destatis) 2010 – 2022

Të dhënat e vitit 2022 tregojnë se nga gjithsej 330 mijë persona të lindur në Kosovë, moshë mesatare në kohën kur ata emigruan në Gjermani ishte 22 vjeç.


Figura 4. Moshë mesatare e diasporës kosovare në kohën e migrimit të tyre në Gjermani, 2010 – 2022

Burimi: Zyra Federale e Statistikave të Gjermanisë (Destatis) 2010 – 2022

Nga gjithsej 16 njësi federative nga të cilat përbëhet Gjermania, pjesa më e madhe e personave me origjinë nga Kosova jetojnë në Baden-Wuerttemberg, Nordrhein-Westfalen dhe Bavari (Tabela 2 në aneks).¹⁵

Të dhënat e fundit të edukimit të përgjithshëm tregojnë se numri i personave të cilët posedojnë diplomë të shkollës së mesme është 281 mijë, krahasuar me 87 mijë të cilët nuk kanë diplomë të tillë. Pjesa tjetër prej 174 mijë, përfshin personat të cilët janë ende duke u shkolluar apo nuk e kanë arritur ende moshën për të vijuar mësimet. Çdo vit, përgjatë 2010–2022, niveli i personave me diplomë të shkollës së mesme ka qenë më i lartë se ata të cilët nuk kanë diplomë, apo ata të cilët janë ende duke vijuar mësimet.


¹⁵ Të dhënat për popullsi me origjinë nga Kosova të cilët jetojnë në Brandenburg, Bremen, Hamburg, Saarland, Saxony, Saxony-Anhalt, dhe Thuringia mungojnë/ nuk janë të paraqitura në mikrocensus.

Figura 5. Diaspora kosovare në Gjermani sipas edukimit të përgjithshëm, 2010 – 2022

Burimi: Zyra Federale e Statistikave të Gjermanisë (Destatis) 2010 – 2022


Të dhënat e fundit tregojnë se 160 mijë burra posedojnë diplomë të shkollës së mesme, krahasuar me 121 mijë gra të cilat posedojnë diplomë të tillë. Numri i grave pa diplomë të shkollës së mesme (48 mijë) është më i lartë se numri i burrave pa diplomë të tillë (38 mijë).

Ndërsa, 89 mijë burra e djem dhe 85 mijë gra e vajza, ende nuk i takojnë moshës shkollore ose nuk kanë përfunduar ende shkollimin.

Figura 6. Edukimi i përgjithshëm i diasporës kosovare në Gjermani sipas gjinisë, 2010 – 2022


Burimi: Zyra Federale e Statistikave të Gjermanisë (Destatis) 2010 – 2022

Sa i përket kualifikimeve profesionale, çdo vit radhazi, numri i personave pa kualifikime profesionale ka qenë më i lartë sesa ata me kualifikime të tilla. Të dhënat e fundit tregojnë se 113 mijë persona posedojnë kualifikime profesionale, krahasuar me 222 mijë të cilët nuk kanë kualifikime profesionale. Ndërkaq, 208 mijë janë ende duke u trajnuar/shkolluar.

Figura 7. Diaspora kosovare në Gjermani sipas kualifikimeve profesionale, 2010 – 2022

Burimi: Zyra Federale e Statistikave të Gjermanisë (Destatis) 2010 – 2022


Numri i burrave të cilët posedojnë kualifikime profesionale (67 mijë) është më i lartë se i grave të cilat posedojnë kualifikime të tilla (46 mijë). Për dallim nga edukimi i përgjithshëm, ku numri i grave pa diplomë të shkollës së mesme ishte më i lartë se i burrave, në rastin e kualifikimeve profesionale numri i grave pa asnjë kualifikim profesional (107 mijë) është më i ulët se numri i burrave pa një kualifikim të tillë (115 mijë). Ndërsa, 107 mijë burra dhe 101 mijë gra janë ende duke u trajnuar, apo nuk kanë arritur ende moshën e duhur për trajnime.

Figura 8. Kualifikimet e përgjithshme të diasporës kosovare në Gjermani sipas gjinisë, 2010 – 2022

Burimi: Zyra Federale e Statistikave të Gjermanisë (Destatis) 2010 – 2022

Në kategorinë e kualifikimeve profesionale bëjnë pjesë ata të cilët kanë diploma akademike dhe jo-akademike. Diplomat akademike përfshijnë diplomat universitare, ndërkaq diplomat jo-akademike përfshijnë diplomat nga stazhet e punës, kolegjet teknike, dhe të tjera të ngjashme. Nga të dhënat e fundit, numri i personave të cilët posedojnë diploma akademike është 22 mijë, në krahasim me 91 mijë të cilët kanë diploma jo-akademike.


Figura 9. Diaspora kosovare në Gjermani me kualifikime profesionale (akademike dhe jo-akademike), 2010 – 2022



Burimi: Zyra Federale e Statistikave të Gjermanisë (Destatis) 2010 – 2022

Në strukturën e familjeve të personave me origjinë nga Kosova që jetojnë në Gjermani, rezulton se shumica prej tyre jetojnë në familje me tre apo më shumë anëtarë. Të dhënat e vitit 2022 tregojnë se 29 mijë persona jetojnë vetëm, 37 mijë familje përbëhen nga dy anëtarë, ndërsa pjesa tjetër përfshin 123 mijë familje të cilat përbëhen nga tre ose më shumë anëtarë.


Figura 10. Diaspora kosovare në Gjermani sipas strukturës familjare, 2010 – 2022



Burimi: Zyra Federale e Statistikave të Gjermanisë (Destatis) 2010 – 2022

Nga numri total i personave të cilët përshihen në sfondin e migrimit nga Kosova, të dhënat e vitit 2022 paraqesin 264 mijë persona aktivë në fuqinë punëtore, nga të cilët, 251 mijë janë të punësuar, ndërsa 13 mijë të papunë. Në vitin 2017 vërehet rritje e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore. Kjo rritje reflektohet në të dy gjinitë, e cila është kryesisht pasojë e politikave të lehtësuara të migrimit për tërheqje të fuqisë punëtore nga shteti i Gjermanisë.


Figura 11. Figura 11. Diaspora kosovare në Gjermani sipas fuqisë punëtore, 2010 – 2022



Burimi: Zyra Federale e Statistikave të Gjermanisë (Destatis) 2010 – 2022

Numri i burrave të punësuar është konsiderueshëm më i lartë se i grave. Nga gjithsej 251 mijë të punësuar, të dhënat e fundit të vitit 2022 tregojnë se 160 mijë (63.7%) janë burra, krahasuar me 91 mijë gra (36.3%).

Figura 12. Fuqia punëtore e diasporës kosovare në Gjermani sipas ndarjes gjinore, 2010 – 2022




Burimi: Zyra Federale e Statistikave të Gjermanisë (Destatis) 2010 – 2022

Me përjashtim të personave të punësuar, të tjerët jetojnë duke pranuar përfitime të papunësisë, mbështetje nga të afërmit, pensione, dhe mbështetje të tjera nga qeveria (Figura 13).¹⁶ Mbështetja nga të afërmit rezulton të jetë më e larta te personat që nuk janë pjesë e tregut të punës, kjo kryesisht sepse shumica prej tyre ende nuk i takojnë moshës së lejuar për punë.

¹⁶ Te mbështetjet tjera nga qeveria përfshihen: ndihma sociale, përfitime të azilkërkuesve, shtesa prindërore, shtesa arsimore dhe të ngjashme.


Figura 13. Fuqia punëtore e diasporës kosovare në Gjermani sipas mënyrës së jetesës, 2010 – 2022



Burimi: Zyra Federale e Statistikave të Gjermanisë (Destatis) 2010 – 2022

Pjesa më e madhe e diasporës kosovare nga Gjermania i takojnë grupit të të hyrave mujore prej 2,000–2,500 euro neto për person. Numri i tyre bie me rritjen e të hyrave mbi 2,500 euro neto.¹⁷

Figura 14. Të hyrat mujore neto për person të diasporës kosovare të punësuar në Gjermani, 2022




Burimi: Zyra Federale e Statistikave të Gjermanisë (Destatis) 2010 – 2022

Sipas të dhënave të vitit 2022, 26 mijë gra pranojnë të hyra mujore nga 500-1000 euro neto, krahasuar me vetëm 14 mijë burra të cilët pranojnë të hyra të tilla. Dallimi i të hyrave mujore prej 1000–1500 euro neto është më i ulët, me 14 gra mijë dhe 19 mijë burra që pranojnë shuma të tilla mujore. Megjithatë, në të hyrat mbi 1500 euro neto, burrat dominojnë konsiderueshëm krahasuar me gratë. Numri i burrave të cilët pranojnë të hyra mujore prej 1500–2000 euro neto është 35 mijë në krahasim me 12 mijë gra. Ndërsa, te shumatat më të mëdha, në këtë rast, prej 2000–2500 euro neto, dominojnë burrat me numër 47 mijë krahasuar me vetëm 8 mijë gra të cilat pranojnë të hyra me vlerë më të madhe.¹⁸

¹⁷ Të dhënat për të hyrat mujore mbi 3,500 euro neto mungojnë.

¹⁸ Ndarjet gjinore për të hyrat mujore neto te kategoria nën 500 euro, si dhe te kategoria mbi 2500 euro, mungojnë/nuk janë të paraqitura në mikrocensus.


Figura 15. Të hyrat mujore neto të diasporës kosovare të punësuar në Gjermani sipas ndarjes gjinore, 2022



Burimi: Zyra Federale e Statistikave të Gjermanisë (Destatis) 2010 – 2022

Të dhënat nga viti 2017 deri në 2022 tregojnë se arsyet kryesore të emigrimit në Gjermani për të gjithë personat e lindur në Kosovë janë kryesisht bashkimi familjar dhe azil-kërkimi. Në vitin 2022, 110 mijë persona deklaruan se bashkimi familjar është arsyeja kryesore e emigrimit të tyre; 85 mijë persona deklaruan se arsyeja kryesore është arratisja, azil-kërkimi dhe mbrojtja ndërkombëtare; 64 mijë persona deklaruan si arsye punësimin, ndërsa 41 mijë të tjerë emigruan për të krijuar familje.¹⁹

Figura 16. Arsyet e migrimit të diasporës kosovare në Gjermani, 2010-2022




Burimi: Zyra Federale e Statistikave të Gjermanisë (Destatis) 2010 – 2022

Punësimi është arsyeja kryesore e emigrimit të burrave, krahasuar me gratë të cilat kryesisht emigruan për arsye të bashkimit familjar. Nga të dhënat e vitit 2022, numri i burrave të cilët deklaruan se punësimi është arsyeja kryesore e emigrimit të tyre në Gjermani është 55 mijë; duke pasuar me 52 mijë të cilët deklaruan se arratisja, azil kërkimi dhe mbrojtja ndërkombëtare është arsyeja kryesore e emigrimit të tyre; 42 mijë emigruan për bashkim familjar, dhe 13 mijë për krijim të familjes. Arsyet e emigrimit të gratë ndryshojnë, ku 68 mijë

¹⁹ Arsyet tjera përfshijnë studimet, trajnimet, lirinë e lëvizjes në BE dhe të tjera – të dhënat e të cilave mungojnë.

prej tyre deklaruan se bashkimi familjar është arsyeja kryesore e migrimit drejt Gjermanisë; pasuar nga 33 mijë të cilat deklaruan se arratisja, azil kërkimi dhe mbrojtja ndërkombëtare është arsyeja kryesore e emigrimit; 29 mijë deklaruan se planet për krijim të familjes në Gjermani ishin vendimtare në emigrimin e tyre, krahasuar me vetëm 10 mijë të cilat emigruan për arsye të punësimit.


Figura 17. Arsyet e migrimit të diasporës kosovare në Gjermani sipas gjinisë, 2010–2022



Burimi: Zyra Federale e Statistikave të Gjermanisë (Destatis) 2010 – 2022

Bazuar në të dhënat e vitit 2022, 107 mijë persona me sfond migrimi nga Kosova flasin vetëm gjuhën gjermane, 76 mijë flasin kryesisht gjuhën gjermane, dhe 359 mijë flasin gjuhë jo-gjermane ku përfshihen gjuha shqipe, gjuha serbe, gjuhët evropiane, dhe gjuhët tjera. Në këtë kategori, dominon gjuha shqipe e cila flitet nga 306 mijë persona.


Figura 18. Diaspora kosovare sipas gjuhëve të folura brenda familjeve të tyre, 2022



Burimi: Zyra Federale e Statistikave të Gjermanisë (Destatis) 2010 – 2022

Sipas të dhënave të fundit, 95 mijë persona punojnë në sektorin e industrisë përpunuese; 65 mijë persona punojnë në sektorin e tregtisë, hotelarisë dhe transportit; ndërsa 87 mijë persona punojnë në shërbime tjera.²⁰


²⁰ Të dhënat për të punësuarit në sektorët ekonomikë të bujqësisë, pylltarisë, peshkimit, dhe të administratës publike mungojnë/ nuk janë të paraqitura në mikrocensus. E njëjta vlen edhe për të dhënat për ndarje gjinore sipas sektorëve ekonomikë.

Figura 19. Punësimi i diasporës kosovare sipas sektorëve ekonomikë, 2010 – 2022

Burimi: Zyra Federale e Statistikave të Gjermanisë (Destatis) 2010 – 2022

Të dhënat e fundit mbi migrimin e personave me origjinë nga Kosova janë të paraqitura vetëm për vitet 2011–2021. Në vitin 2021, 21,468 persona kanë hyrë nga Kosova në Gjermani, ndërkaq 4,323 persona me origjinë nga Kosova janë larguar nga Gjermania.

Në periudhën 2011–2021, shifra më e lartë e personave që kanë hyrë në shtetin e Gjermanisë nga Kosova shënohet në vitin 2015, me gjithsej 44,081 imigrantë. Ky vit po ashtu paraqet edhe numrin më të lartë të largimit nga Gjermania, me 21,858 emigrantë. Viti 2015 poashtu paraqet migrimin më të lartë neto në 11 vite, që rezulton të jetë 22,223 persona, ndërkaq, ndryshimet e fundit të migrimit neto të vitit 2021, janë ekuivalent me 17,164 persona.

Figura 20. Lëvizjet e popullsisë nga Kosova në Gjermani sipas të dhënave zyrtare gjermane, 2011 – 2021

Burimi: Zyra Federale e Statistikave të Gjermanisë (Destatis) 2011 – 2021

Përfundim

Në këtë analizë statistikore, Instituti GAP paraqiti të dhëna të detajuara të numrit të kosovarëve të cilët jetojnë në Gjermani, duke u bazuar në rezultatet e regjistrimeve/mikrocensuseve nga Zyra Federale e Statistikave të Gjermanisë për vitet 2010 – 2022.

Rezultatet kryesore tregojnë se në Gjermani jetojnë 542 mijë persona me sfond migrimi nga Kosova (289 mijë burra dhe 254 mijë gra). Nga gjithsej 542 mijë persona, 330 mijë kanë lindur në Kosovë. Pjesa më e madhe e personave me origjinë nga Kosova jetojnë në Baden-Wuerttemberg, Nordrhein-Westfalen dhe Bavari. Grup-mosha e cila dominon te personat me sfond migrimi nga Kosova është 25 deri në 45 vjeç.

Numri i personave nga Kosova të cilët janë aktivë në tregun e punës në Gjermani është 264 mijë (251 mijë janë të punësuar ndërsa 13 mijë janë të papunë). Burrat dominojnë me pjesëmarrje më të lartë në tregun e punës. Të dhënat nga edukimi i përgjithshëm tregojnë se numri i personave të cilët posedojnë diplomë të shkollës së mesme është më i madh se ata të cilët nuk kanë diplomë të tillë. Ndërsa për kualifikime profesionale, numri i personave të cilët nuk kanë kualifikime profesionale është më i madh se ata të cilët kanë kualifikime të tilla.

Arsyet e migrimit të burrave dhe grave ndryshojnë. Punësimi është arsyeja kryesore e emigrimit të burrave, krahasuar me gratë të cilat kryesisht emigruan për arsye të bashkimit familjar. Gjermania historikisht ka qenë destinacioni kryesor i emigrantëve nga Kosova. Përmes miratimit të politikave të cilat e lehtësojnë migrimin drejt saj, Gjermania vazhdon të tërheq emigrantë kosovarë, trendi i largimit të të cilëve është duke u reflektuar në masë të madhe.

Aneks

Tabela 1. Diaspora kosovare në Gjermani sipas grup-moshave, 2010–2022

Vlerat në mijëra (,000)

| Mosha | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 |
|-------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|
| <5 | 36 | 31 | 39 | 34 | 34 | 35 | 38 | 44 | 44 | 45 | 41 | 42 | 47 |
| 5-10 | 30 | 27 | 37 | 35 | 37 | 35 | 39 | 42 | 46 | 44 | 45 | 43 | 48 |
| 10-15 | 31 | 28 | 33 | 30 | 31 | 30 | 32 | 41 | 45 | 48 | 42 | 47 | 52 |
| 15-20 | 29 | 23 | 24 | 26 | 28 | 30 | 34 | 40 | 40 | 43 | 39 | 46 | 48 |
| 20-25 | 19 | 20 | 23 | 25 | 24 | 25 | 26 | 31 | 36 | 37 | 39 | 44 | 47 |
| 25-30 | 25 | 22 | 22 | 22 | 22 | 23 | 32 | 34 | 38 | 37 | 38 | 40 | 45 |
| 30-35 | 29 | 25 | 28 | 24 | 27 | 29 | 28 | 34 | 36 | 36 | 38 | 37 | 50 |
| 35-40 | 28 | 26 | 30 | 31 | 31 | 34 | 31 | 35 | 39 | 35 | 33 | 35 | 41 |
| 40-45 | 21 | 21 | 25 | 28 | 27 | 28 | 32 | 35 | 38 | 38 | 35 | 40 | 40 |
| 45-50 | 16 | 17 | 17 | 19 | 20 | 20 | 24 | 31 | 38 | 41 | 38 | 41 | 44 |
| 50-55 | 8 | 10 | 12 | 13 | 12 | 12 | 15 | 26 | 27 | 28 | 26 | 29 | 32 |
| 55-60 | 7 | 7 | 9 | 10 | 9 | 8 | 9 | 11 | 13 | 14 | 12 | 16 | 19 |
| 60-65 | / | 5 | / | / | 6 | 6 | 8 | 6 | 8 | 10 | / | 9 | 11 |
| 65-70 | / | / | / | / | / | / | 6 | 7 | 7 | 7 | / | / | / |
| 70-75 | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / |
| 75-80 | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / |
| 80-85 | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / |
| 85-90 | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / |
| 90-95 | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / |
| 95> | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / |

Burimi: Zyra Federale e Statistikave të Gjermanisë (Destatis) 2010 – 2022.

Tabela 2. Vendbanimet kryesore të diasporës kosovare në Gjermani, 2010 – 2022

Vlerat në mijëra (,000)

| | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 |
|-------------------------------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|
| Baden-Wuerttemberg | 74 | 68 | 81 | 83 | 96 | 92 | 98 | 111 | 122 | 125 | 111 | 128 | 136 |
| Bavaria | 61 | 57 | 60 | 66 | 66 | 71 | 71 | 82 | 93 | 95 | 102 | 95 | 118 |
| Berlin | 7 | / | 7 | 5 | 6 | 7 | 9 | 12 | 8 | 6 | / | / | 15 |
| Brandenburg | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / |
| Bremen | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / |
| Hamburg | / | / | / | / | / | / | / | 8 | 7 | 6 | / | / | / |
| Hesse | 16 | 16 | 22 | 25 | 21 | 21 | 22 | 25 | 32 | 35 | 33 | 36 | 31 |
| Mecklenburg-Western Pomerania | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / |
| Lower Saxony | 25 | 22 | 27 | 26 | 20 | 19 | 31 | 38 | 41 | 44 | 36 | 52 | 47 |
| North Rhine-Westphalia | 76 | 72 | 84 | 74 | 76 | 77 | 82 | 98 | 103 | 103 | 88 | 102 | 116 |
| Rhineland-Palatinate | 14 | 12 | 14 | 14 | 14 | 13 | 22 | 21 | 29 | 29 | 31 | 30 | 36 |
| Saarland | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / |
| Saxony | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / |
| Saxony-Anhalt | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / |
| Schleswig Holstein | 9 | 7 | 6 | / | / | 7 | 7 | 13 | 13 | 13 | / | 11 | 9 |
| Thuringia | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / |

Burimi: Zyra Federale e Statistikave të Gjermanisë (Destatis) 2010 – 2022

Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të vitit 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mes qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

www.institutigap.org

Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr. 4, 10000 Prishtinë

Tel.: +383 38 609 339


info@institutigap.org

Instituti GAP mbështetet nga:



Rockefeller
Brothers Fund

Philanthropy for an Interdependent World



**Migrimi i kosovarëve
në Gjermani:
Analizë statistikore**